



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.85

11 korrik

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9761 datë 25.6.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe “Tergeste” Srl Trieste (Itali) për riskedulimin e borxheve të prapambetura”	2499
Ligj nr.9763 datë 28.6.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për programin e barazisë gjinore, Shqipëri”	2501

LIGJ
Nr.9761, datë 25.6.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE “TERGESTEA” SRL TRIESTE (ITALI) PËR RISKEDULIMIN E BORXHEVE TË PRAPAMBETURA”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe “Tergeste” Srl Trieste (Itali) për riskedulimin e borxheve të prapambetura”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5385, datë 2.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TERGESTEA SRL TRIESTE (ITALI) NË LIDHJE ME RISKEDULIMIN E BORXHEVE TË PAPAGUARA

Marrëveshje e datës __/__/2007, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu i quajtur “Këshilli”, i përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar për Negociimin e Borxhit të Jashtëm të Shqipërisë (këtu i quajtur (GCNEDA) dhe “Tergeste” Srl Trieste, i përfaqësuar nga Z.Guido Valenzin.

Neni 1

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i borxheve të paguara, që rrjedhin nga transaksionet tregtare, ndërmjet “Tergeste” Srl dhe ish-ndërmarrjeve shqiptare shtetërore të tregtisë me jashtë.

Këshilli dhe Tergeste Srl bien dakord që:

shuma e borxheve të ish-ndërmarrjeve shqiptare shtetërore të tregtisë me jashtë ndaj “Tergeste” Srl arrin në 292.168.333,00 ITL.

Shuma e borxhit të “Tergeste” Srl ndaj parkut të mallrave të eksportit Durrës arrin në 38.315,00 Usd.

Neni 2

Shuma prej 292.168.333,00 ITL duhet të konvertohet në euro me një kurs të caktuar nga Këshilli i Bashkimit Europian më 31 dhjetor 1998. Kështu, borxhi ndaj “Tergeste” Srl duhet të jetë 150.892,40 euro.

Shuma prej 38.315,00 USD duhet të konvertohet në euro me një kurs EURO/USD të datës 20 shkurt 2007. Kështu borxhi ndaj palës shqiptare duhet të jetë 29.128,00 EURO.

Neni 3

Këshilli dhe “Tergeste” Srl bien dakord që shuma totale e borxheve të Këshillit ndaj “Tergeste” Srl duhet të jetë 121.764.40 euro.

Neni 4

Këshilli do të shlyejë borxhin ndaj “Tergeste” Srl në shumë prej 121.764, 40 euro në një këst që bëhet i pagueshëm më 30 qershor 2007.

Neni 5

Këshilli i paguan “Tergeste” Srl interes për shumën e borxhit në pajtim me nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, në nivelin LIBOR me bazë 6-mujore, në vit, për periudhën që fillon më 31 gusht 2006 deri në datën që është e kërkueshme pagesa e shumës principale.

Neni 6

“Tergeste” Srl heq dorë nga kërkesa për interesat e vjetra për periudhën nga data e maturimit të pretendimeve deri më 31 gusht 2006.

Neni 7

Në rastin e vonesës në shlyerjen e kërkueshme në bazë të nenit 3, norma e interesit të përcaktuar në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje rritet me pikë një për qind, nga data që bëhet e kërkueshme shlyerja e kështit deri në datën në të cilën merret pagesa.

Neni 8

Çdo pagesë në favor të “Tergeste” Srl realizohet në llogarinë përkatëse që njoftohet nga “Tergeste” Srl.

Neni 9

Kjo Marrëveshje nuk ndryshohet pa pëlqimin me shkrim të të dy Palëve.

Neni 10

Njoftimet bëhen në pajtim me këtë Marrëveshje dhe në adresat e mëposhtme:

Këshilli:

Ministra e Financave

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri

Tel: +3554228405

Fax: +3554229200

“Tergeste” Srl:

Via Del Canal Piccolo, 2 – 34121 Trieste

Tel: +39 040 7777221
Fax: +39 040 365262

Neni 11

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të nevojshme ligjore të kërkuara nga legjislacioni shqiptar dhe është e vlefshme dhe detyruese për Palët deri se ato të përmbushin detyrimet parashikuara prej saj.

Bërë në Tiranë, më.....2007, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr.9763, datë 28.6.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR PROGRAMIN E BARAZISË GJINORE, SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për programin e barazisë gjinore, Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5387, datë 2.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Mbështetur në ligjin mbi bashkëpunimin për zhvillim, botuar në Fletoren Juridike Federale, nr.49/2002, të amenduar, Agjencia Austriake për Zhvillim me adresë 1010 Vienna, Zelinkagasse 2 (këtu e tutje referuar si “Donatori”) dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të Republikës së Shqipërisë, Rr.Kavaja 53, Tiranë, Shqipëri (këtu e tutje referuar si “Përfituesi”) arritën sa më poshtë:

MARRËVESHJE GRANTI

Numri i kontratës: 8146-00/2006

Titulli i kontratës: Programi i barazisë gjinore, Shqipëri

§ 1. Financimi

Donatori merr përsipër t’i paguajë përfituesit vlerën maksimale prej 785 000 euro (me fjalë: shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë euro). Pagesat do të bëhen në varësi të ecurisë së projektit.

§ 2. Qëllimi i grantit

Qëllimi i grantit është financimi i projektit me titull: “Programi i barazisë gjinore, Shqipëri”, siç përshkruhet në shtojcat e kontratës së shërbimit, të nënshkruar nga Përfituesi dhe

Kontraktuesi (këtu e tutje referuar si kontratë shërbimi). Kontrata e shërbimit është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së grantit.

§ 3. Kërkesat e grantit

1. Kontrata e shërbimit me shtojcat e saj

Pritshmëritë që burojnë nga kjo Marrëveshje bëhen të vlefshme vetëm pas paraqitjes së tyre në kontratën e shërbimit, të nënshkruar nga të dyja Palët ndaj Donatorit.

2. Garancia nga ana e Përfituesit

Përfituesi garanton të ekzekutojë ose të kryejë ekzekutimin e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit. Kjo përfshin vënien në dispozicion të burimeve, shërbimeve dhe mjeteve të tjera që ai disponon. Ai nuk duhet të veprojë në mënyra që mund të dëmtonin ose pengonin zbatimin e projektit.

3. Shërbimet që ofron Përfituesi*

Përfituesi merr përsipër të ofrojë të gjitha shërbimet e përshkruara hollësisht në shtojcën 4 të kontratës së shërbimit, në veçanti shërbimet e mëposhtme:

3.1 Vënia në dispozicion e dokumenteve dhe e informacionit

Përfituesi do të sigurojë të gjitha të dhënat, dokumentacionin dhe informacionin (edhe nga palë të treta ligjore) që ekziston në Shqipëri dhe që nevojitet për projektin dhe do t'i ofrojë ato pa pagesë. Kjo përfshin të gjitha raportet, dokumentet, planet, dokumentet për planifikimin etj.

Përfituesi është përgjegjës për përkthimin e këtyre dokumenteve, nëse kjo do të ishte e nevojshme.

Gjithashtu, Përfituesi siguron përdorimin falas të të gjitha hapësirave dhe të të gjitha dokumenteve që do të kishin rëndësi për projektin.

3.3 Vënia në dispozicion e hapësirave, shërbimeve dhe materialeve

Përfituesi garanton vënien në dispozicion të hapësirave dhe shërbimeve të nevojshme në mbështetje të zbatimit të projektit. Në veçanti, Përfituesi do të garantojë ruajtjen e sigurt dhe në kushte të përshtatshme të të gjitha materialeve, makinerive dhe pajisjeve të blera nga buxheti i projektit. Kostot për personelin e sigurimit, që mund të jetë i nevojshëm apo për ndërtime shtesë për të rritur sigurinë e objektit, do të merren përsipër nga Përfituesi.

Nëse Përfituesi nuk përmbush detyrimet e tij për të ruajtur materialin që do të instalohet në vend dhe nëse ky material humbet, granti do të pakësohet në vlerë të barabartë me humbjen e pësuar. Në këtë rast, Përfituesi është i detyruar që të zëvendësojë materialin e humbur, që është i nevojshëm për zbatimin e projektit.

3.4 Ndihma për marrëdhëniet me autoritetet publike

Përfituesi do të sigurojë, ndihmojë për sigurimin e autorizimeve, licencave dhe lejeve të tjera që lëshohen nga autoritetet qendrore dhe/ose vendore në lidhje me realizimin e projektit.

Përfituesi merr përsipër të kërkojë përjashtimin nga detyrimi për pagesat e kostove, taksave dhe nga detyrime të tjera që mund të dalin lidhur me sa më lart.

3.5 Vënia në dispozicion e personelit përkatës

Përfituesi dhe agjencitë dhe autoritetet vendore që varen prej tij do të bashkëpunojnë me kontraktuesin për të garantuar arritjen e objektivave të projektit. Kontraktuesi garanton vënien në dispozicion dhe pagesën e personelit përkatës për zbatimin e të gjitha detyrave që duhet të kryhen nga Përfituesi, sikurse edhe trajnimin e nevojshëm për përdorimin e pajisjeve dhe makinave të ofruara në kuadrin e projektit për gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit. Personeli zgjidhet pas konsultimit me drejtorin e njësisë përfituese dhe menaxherin e projektit austriak.

3.6 Njësia e Koordinimit të Projektit (NJKP):

Për bashkërendimin optimal të të gjitha palëve që marrin pjesë në projekt, Donatori do të ngrejë Njësinë për Koordinimin e Projektit (NJKP), që do të mblidhet, kur lind nevoja, nga Donatori. Kjo njësi përbëhet nga një përfaqësues prej secilës prej agjencive të mëposhtme:

- Donatori, Zyra për Koordinim (Tiranë)
- Drejtoria e Shanseve të Barabarta (DEC) në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) të Republikës së Shqipërisë
- Departamenti i Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore (DDLG) në Ministrinë e

Brendshme të Republikës së Shqipërisë

• Departamenti për Strategjinë dhe Koordinimin e Donatorëve (DSDC) pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

• Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim (GADC)

• Horizont 3000

Donatori merr përsipër të vërë në dispozicion të NJKP-së personel të kualifikuar dhe të autorizuar.

3.7 Përjashtimi nga të gjitha taksat dhe detyrimet

Mallrat dhe shërbimet e marra gjatë zbatimit të projektit duhet të përjashtohen nga të gjitha taksat dhe detyrimet në Shqipëri, duke përfshirë detyrimet doganore dhe qiratë për magazinimin, sikurse edhe kostot për lejet, autorizimet dhe komisionet. Kjo vlen, po ashtu edhe për pajisjet e importuara gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe që do të eksportohen pas përfundimit të tij. Ky përjashtim përfshin edhe mallrat dhe shërbimet e blera brenda vendit dhe kontributet e tjera të dhëna nga nënkontraktuesit. Nëse gjatë zbatimit të projektit, do të paguhet në Shqipëri taksa dhe detyrime të tjera, ato do të jenë përgjegjësia e Përfituesit dhe nuk do të konsiderohen si kosto të grantit.

Përfituesi garanton që mallrat e importuara për në Shqipëri, të zhdoganohen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se shtatë ditë nga data e mbërritjes. Kostot për parkimin apo magazinimin dhe çdo kosto tjetër që shkaktohet nga vonesat në zbatimin e projektit, megjithëse për faj të Përfituesit ose të autoriteteve kompetente në vendin pritës, do të paguhet nga buxheti i projektit. Vonosat për zhdoganimin mund të çojnë deri në ndërprerjen përfundimtare ose të përkohshme të projektit nga ana e Donatorit.

4. Pronësia, mbrojtja e aseteve financiare dhe pasurive të patundshme

Përfituesi garanton që llogaritë e projektit, sikurse zotërimet financiare dhe pasuritë e patundshme, të gëzojnë ruajtje të posaçme. Kjo përfshin mbrojtjen kundër sekuestrimit të pjeshëm ose të plotë, si dhe kundër bllokimit që mund të bëhet nga agjenci administrative, banka ose agjenci të tjera.

5. Pagesa e fondeve të grantit ndaj Kontraktuesit dhe kontabilitetit

Përfituesi bie dakord që pagesa e fondeve të grantit të bëhet nga Donatori te Kontraktuesi dhe autorizon Donatorin që të shqyrtojë llogaritë në përputhje me seksionin 2 të kontratës së shërbimit dhe pikën 4 të kushteve të përgjithshme të kontratës (shih gjithashtu pikën 1 të deklaratës).

6. Transferimi i detyrimeve që burojnë nga kontrata e shërbimeve

Përfituesi bie dakord që me kërkesën e Donatorit, çdo detyrim që buron nga kontrata e shërbimit që Përfituesi mund të ketë për kontraktuesin mund t'i transferohet Donatorit (shih gjithashtu pikën IV.1 të deklaratës).

7. Transferimi i së drejtës së pronësisë

Përfituesi i transferon Donatorit të gjitha të drejtat e pronësisë që burojnë nga kontrata e shërbimit (pika 14.3 e kushtet e përgjithshme të kontratës). Këto të drejta janë të pakufizuara në kohë ose në hapësirë dhe janë jo ekskluzive. Ai gjithashtu i transferon Donatorit të drejtën për t'ua kaluar të drejtat e përmendura më lart palëve të treta (shih gjithashtu pikën IV.2 të deklaratës).

8. Monitorimi i projektit

Përfituesi bie dakord që kryerja e detyrave në përputhje me kontratën të sigurohet nga monitorimi i projektit i autorizuar nga Donatori (shqyrtimi i detyrave të caktuara, i bërë nga ekspertët) (shih pika IV.3 e deklaratës). Kostoja e monitorimit do të paguhet nga Donatori.

9. Kontratat e nënshërbimit, rihënja e shërbimeve

Përfituesi ka rënë dakord që dhënia e nënshërbimit dhe kontratat për furnizimet e paparashikuara në shtojcat e kontratës së shërbimit kërkojnë miratimin paraprak me shkrim të Donatorit, në përputhje me pikën 1.6 të kushteve të përgjithshme të kontratës. Riakordimi i shërbimeve kërkon, gjithashtu miratimin paraprak të Donatorit.

10. Investimet

Përfituesi bie dakord që riakordimi i kontributeve në natyrë, sikurse edhe dhënia e kontributeve të tjera të përfshira në pikën "artikuj të tjerë" kërkon miratimin paraprak të dhuruesit ose të këshilltarit që monitoron projektin, nëse ekziston një i tillë.

Modifikimet e rëndësishme të objektivave të projektit kërkojnë, gjithashtu miratimin paraprak me shkrim të Donatorit. Vendimet ose investimet strategjike të Përfituesit kërkojnë miratimin e Donatorit.

11. Modifikimi i projektit

Donatori ka të drejtën që në çdo kohë të kërkojë modifikime të projektit, nëse rrethana të caktuara do t'i bënin ato të nevojshme. Përfituesi do të njoftojë menjëherë Donatorin për kostot shtesë. Përfituesi është i detyruar të bëjë modifikimet e projektit vetëm në rastin kur është arritur një marrëveshje financiare shtesë me shkrim. Në mungesë të kësaj marrëveshjeje shtesë ose të një raportimi të menjëhershëm të kësaj marrëveshjeje, Përfituesi nuk do të rimbursohet për kostot shtesë.

12. Detyrime të tjera

Përfituesi merr përsipër:

1. të përdorë burimet financiare në mënyrë eficiente dhe të shpejtë;
2. të raportojë menjëherë të gjitha rrethanat që do të mund të vononin ose bënin të pamundur zbatimin e projektit.

§ 4 Detyrimet e tjera të Përfituesit

Përfituesi merr përsipër:

1. të mos hyjë në marrëveshje jozyrtare jashtë kontratës së shërbimit, pa miratimin e Donatorit (shih seksionin 8, paragrafi 2 i kontratës së shërbimit);
2. të njoftojë menjëherë dhuruesin për çdo rrethanë që do të mund të vononte ose bënte të pamundur kryerjen e detyrave ose arritjen e qëllimit të grantit, ose që do të bënte të nevojshëm një përmirësim të marrëveshjes së grantit apo të kontratës së shërbimit dhe të dorëzonte sugjerimet e duhura për masat që duhen marrë. Nëse njoftimi i lartpërmendur nuk është bërë me shkrim, ai duhet të pasohet nga një konfirmim me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur;
3. të lejojë Donatorin ose agjentët e tij që në çdo kohë të kryejnë inspektime në terren dhe t'u japë atyre informacionin e nevojshëm lidhur me projektin;
4. nëse Përfituesi ka dhënë fonde nga burimet e veta ose ka marrë fonde nga palë të treta të ligjshme, raporti përfundimtar duhet të mbulojë të gjitha shërbimet e financuara nga këto burime dhe të përfshijë një pasqyrim numerik të tyre (raporti i kostove);
5. për t'i bërë të njohur Donatorit çdo publikim lidhur me projektin dhe për të siguruar që të gjitha publikimet lidhur me projektin mbajnë shënimin "financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim" të vendosur në një vend të dukshëm në gjuhën vendase (shih pikën 7 të kushteve të përgjithshme të kontratës);
6. të mos pretojë, transferojë ose japë të drejta që burojnë nga kontrata ose të heqë dorë nga këto të drejta në ndonjë rrugë tjetër. Të drejtat e transferuara në këtë mënyrë do të jenë të pavlefshme për dhuruesin;
7. të organizojë të gjithë dokumentacionin që lidhet me projektin dhe ta ruajë atë në një vend të sigurt për të paktën dhjetë vjet. Periudha për ruajtjen e dokumentacionit fillon nga data e paraqitjes së raportit përfundimtar, në përputhje me seksionin 2 paragrafi 2 i kontratës së shërbimit.

§ 5 Klauzola kundër korrupsionit

Donatori ka të drejtën të ndërpresë kontratën ose të marrë masat e duhura rregulluese, nëse gjatë zbatimit të kontratës, ndonjë personi apo institucioni i ofrohet, premtohet ose i jepet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo një dhuratë, avantazh apo ndonjë përfitim tjetër (shih seksionin 6.1.12).

§ 6 Ndërprerja dhe anulimi i pagesave të grantit

1. Arsyet për ndërprerjen dhe kthimin e pagesave

Përfituesi është i detyruar të bëjë ripagimin e menjëhershëm të grantit, kur kjo i kërkohet me shkrim nga dhuruesi. Në të njëjtën kohë, çdo e drejtë ndaj fondeve të premtuara pushon së ekzistuari kur:

- 1.1 Agjencitë ose agjentët e Donatorit ose të Bashkimit Europian kanë qenë informuar në mënyrë të pasaktë ose të paplotë lidhur me rrethana vendimtare për akordimin e grantit;
- 1.2 Përdorim i papërshtatshëm, i pjesshëm ose i plotë i fondeve të grantit;

1.3 Projekti nuk mund të zbatohet ose nuk mund të zbatohet në kohë për faj të Përfituesit, në veçanti, nëse shërbimet e Përfituesit nuk janë kryer si duhet ose nuk janë kryer në kohë;

1.4 Mosdorëzimi në kohë i raporteve ose evidencës, ose mosparaqitja e informacionit të nevojshëm, në rastet kur rikujtimi me shkrim për afatet e dorëzimit të informacionit dhe pasojat ligjore në rast të moszbatimit ka qenë i paefektshëm;

1.5 Mosraportimi i menjëhershëm i ngjarjeve që mund të vononin, pengonin, bënë të pamundur zbatimin e projektit ose që mund të kërkonin modifikimin e tij;

1.6 Nisja e procedimeve të falimentimit kundër aseteve të aplikantit ose refuzimi për të nisur procedurat për falimentimin për mungesë të aseteve të mjaftueshme për mbulimin e kostove përpara, ose në prag të përfundimit të projektit, çka do të pengonte arritjen e objektivit të grantit;

1.7 Aplikanti dëmton ose pengon masat e parashikuara për kontrollin;

1.8 Pamundësia për të verifikuar përdorimin e grantit për periudhën 10-vjeçare të parashikuar për ruajtjen e informacionit (shih seksionin 4, paragrafi 7 dhe pikën 4.7 të kushteve të përgjithshme të kontratës);

1.9 Projekti është modifikuar pa miratimin paraprak të Donatorit;

1.10 Garancitë sipas seksioneve 3 L.2 apo L.3 apo L.4 nuk janë përmbushur;

1.11 Aplikanti nuk zbaton kërkesat e grantit, në veçanti ato që garantojnë realizimin e objektivit të grantit;

1.12 Kur një personi ose institucioni i ofrohet, premtohet ose i jepet, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo, një dhuratë, avantazh ose përfitim tjetër që do të ndikonte në akordimin e fondeve ose në zbatimin e projektit;

1.13 Pezullimi dhe/ose tërheqja e kontratës kërkohet nga agjencitë e BE-së, sepse dhurimi bie ndesh me rregulloret e BE-së.

2. Interesi

Nëse Përfituesi ose persona të përdorur prej tij për të hartuar dokumentet e nevojshme për akordimin e grantit, ose për zbatimin e projektit, është/janë përgjegjës për tërheqjen e fondeve, interesi i fondeve të tërhequra do të jetë 3% mbi normën aktuale dhe do të llogaritet nga data e dhënies së fondit. Nëse norma e interesit e llogaritur si më lart del më e ulët nga norma e interesit e aplikuar nga BE-ja për fondet e anuluar, atëherë do të zbatohet norma e BE-së.

3. Kufizimi i vlerave të rikuperueshme

Nëse projekti mund/do të mund të zbatohet pjesërisht (seksioni 1.3) dhe realizimi i pjesëshëm i tij arrin objektivin e grantit, atëherë kthehet vetëm diferenca midis vlerës totale të projektit dhe vlerës së pjesës së kryer të projektit.

Kur vetëm një pjesë e fondeve të grantit është përdorur gabimisht (seksioni 1.2) dhe kjo nuk pengon arritjen e objektivit të grantit, vetëm kjo pjesë e grantit do të jetë e kthyeshme.

4. Rimbursimi i kostove të auditit

Përfituesi do të rimbursojë Donatorin për kostot e auditit të lidhur me paraqitjen e arsyeve për ndërprerjen/anulimin (p.sh. punësimi i audituesve të tjerë, shpenzimet e udhëtimit të agjentëve të donatorit).

5. Ndërprerja e projektit jo për faj të Përfituesit

Nëse projekti nuk mund të zbatohet as edhe në rastin e zgjatjes në kohë të projektit, jo për faj të Përfituesit, Përfituesi do të ndërpresë projektin dhe do të dorëzojë një raport mbi ecurinë e punës, sikurse dhe një raport përfundimtar financiar dhe do t'i kthejë menjëherë të gjitha fondet e pashpenzuara të grantit. Kontraktuesi do t'i dorëzojë të gjitha pasuritë e patundshme të blera me burimet e grantit të Donatori ose në palë të treta të përcaktuara nga Donatori.

6. Çështje të tjera ligjore

Çdo pretendim tjetër ligjor i ngritur nga Agjencia Austriake për Zhvillim nuk do të cenohet nga seksioni 6 paragrafët 1 deri 5.

§ 7 Përdorimi i të dhënave

Përfituesi vëren se të gjitha të dhënat vetjake të vëna në dispozicion me qëllim fillimin dhe zbatimin e kontratës, përdorimi i të cilave është kusht i rëndësishëm për përmbushjen e detyrimeve të Donatorit ose lejohet në përputhje me seksionet 7 deri 9 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave 2000 (Datenschutzgesetz 2000), botuar në Fletoren Juridike Federale nr. 165/1999, të amenduar, mund të

përdoret nga Donatori, me qëllim përfundimin dhe zbatimin e kontratës, sikurse edhe për qëllime kontrolli. Gjatë përdorimit të të dhënave, mund të ndodhë që të dalë nevoja e paraqitjes së tyre agjentëve ose përfaqësuesve të Gjykatës së Auditit, në përputhje me pikat e seksionit 3 paragrafi 2, seksioni 4 paragrafi 1 dhe seksioni 13 paragrafi 3 i ligjit mbi auditin (Rechnungshofgesetz), botuar në Fletoren Juridike Federale nr.144/1948, të amenduar dhe Bashkimit European, në përputhje me dispozitat ligjore të BE-së.

§ 8 Ligji dhe juridiksioni

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga kjo kontratë është rënë dakord që Gjykata e Distriktit 1 të Vjenës do të jetë autoriteti kompetent që ka juridiksionin dhe autoritetin për çështjen në fjalë.

Për çdo vendim në lidhje me marrëdhëniet kontraktuale, do të zbatohet vetëm ligji austriak, me përjashtim të rasteve kur i referohemi ligjit të huaj.

§ 9 Dispozita përmbyllëse

1. Çdo modifikim ose përmirësim i kësaj kontrate duhet të bëhet me shkrim. Në rastet kur njoftimi nuk bëhet me shkrim ai duhet të konfirmohet me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Në rast se për këtë projekt do të ofrohen nga palë të treta fonde shtesë të paparashikuara në këtë projekt (shih pikën § 1.1 të kontratës së shërbimit), financimi i ADA-s do të reduktohet sipas shumës së ofruar nga pala e tretë. Përfutuesi është i detyruar të informojë menjëherë me shkrim ADA-n në rast se ka ndonjë financim shtesë. Këstet e bëra nga ADA do të reduktohen sipas planit të ri të pagesave, të aprovuara nga të gjitha palët kontraktuese, i cili do të zëvendësojë detyrimet e parashikuara në pikat § 3 dhe 4 të kontratës së shërbimit.

3. Kontrata e shërbimit, specifikimet e punës dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së përmirësuar, janë pjesët përbërëse të kontratës. Në rastin kur ka konflikte, Marrëveshja për grantin merr përparësi, ndjekur sipas radhës nga kontrata e shërbimit, specifikimet e punës e së fundi kushtet e përgjithshme të kontratës.

4. Me nënshkrimin e kësaj kontrate Kontraktuesi pranon edhe të gjitha anekset e përmendura në këtë dokument, si dhe që është në dijeni të përmbajtjes së tyre.

5. Marrëveshja hyn në fuqi përkohësisht me nënshkrimin e saj nga Palët dhe efektet e saj fillojnë në momentin, kur Palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të saj.

Tiranë, më 2006

Vjenë, më 2006

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së
Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Punës, Çështjeve
Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Për Agjencinë Austriake për Zhvillim
.....
Dr. Michael Linhart
Drejtor Ekzekutiv

.....
Koço Barka
Ministër
Tiranë, më 2006

Për Ambasadën Austriake
.....
Mag. Klaus DERKOWITSCH,
Ambasador
Tiranë, më 2006

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Rr.Kavaja 53, Tiranë, Shqipëri, si Autoriteti Kontraktues,

dhe HORIZONT 3000 – Organisation für Entwicklungszusammenarbeit, Wohllebengasse 12-14, 1040 Wien (ZVR-Nr. 657802754), si kontraktuesi, kanë arritur sa më poshtë:

KONTRATË SHËRBIMI

Bashkëpunim me Europën Lindore, kontrata nr.8146-00/2006

Titulli i projektit: Programi i barazisë gjinore, Shqipëri

HYRJE

Projekti i paraqitur financohet nga Republika e Austrisë nëpërmjet Agjencisë Austriake për Zhvillim, me adresë 1010 Vienë, Zelinkagasse 2 (referuar këtu e më poshtë si Donatori). Kontrata hyn në fuqi vetëm pasi të jetë përfunduar Marrëveshja e grantit midis Donatorit dhe autoritetit kontraktues si edhe deklarata me fuqi ligjore detyruese e kontraktuesit, shtojca 3, të jetë nënshkruar nga Kontraktuesi dhe t'i jetë dorëzuar Donatorit.

§ 1 Puna që do të kryhet

1. Kontraktuesi bie dakord që të kryejë detyrat e përshkruara në specifikimet e punës, të përshkruara në shtojcën 4. Specifikimet e punës përfshijnë një përshkrim pune, preventivin e kostove të parashikuara dhe llogaritjet mbi të cilat bazohen shumat e përgjithshme dhe pagesat.

2. Kontraktuesi do të ofrojë shërbimet e përshkruara në Marrëveshjen e grantit.

§ 2 Kryerja e punës dhe periudhat e raportimit

1. Detyrat e specifikuara duhet të kryhen sipas afateve të mëposhtme:

1.1 Detyra nis jo më vonë se data 15.12.2006; (1.2) Detyra përfundon jo më vonë se më 31.12.2010.

2. Kontraktuesi merr përsipër të dorëzojë raporte dhe raporte financiare sipas afateve të mëposhtme:

- Paraqitja e një raporti konceptues jo më vonë se data 15.9.2007;

- Paraqitja e një raporti ecurie jo më vonë se datat 31.3.2007; 31.3.2008; 30.9.2008; 31.3.2009; 30.9.2009; 31.3.2010; 30.9.2010;

- Paraqitja e një raporti të ndërmjetëm jo më vonë se datat 30.6.2007; 30.6.2008; 30.6.2009; 30.6.2010;

- Paraqitja e raporteve të ndërmjetme dhe raporteve financiare të ndërmjetme që mbulojnë fondet e projektit të marra deri tani, jo më vonë se datat 31.12.2007; 31.12.2008; 31.12.2009;

- Paraqitja e një raporti përmbledhës përfundimtar dhe një deklaratë përfundimtare financiare për të gjithë kohën e projektit, jo më vonë se 31.12.2010.

3. Pas miratimit nga Autoriteti Kontraktues raportet dhe faturat duhet t'i dorëzohen njëherazi:

1. Donatorit, Koordinatorit për Shqipërinë (kopje elektronike);

2. Autoritetit Kontraktues (kopje elektronike dhe e printuar);

3. Zyrës Austriake të Koordinimit në Tiranë (kopje elektronike dhe e printuar);

Pas miratimit nga Autoriteti Kontraktues, faturat duhet të lëshohen në 1 kopje dhe të dërgohen në adresën e mëposhtme:

ADA, Abteilung Finanz, Recht und Kontrolle, Eblinggasse 5/III, 1010 Wien.

Një tabelë në *Excel* e raporteve përkatëse financiare të përkohshme dhe përfundimtare duhet të dërgohet paralelisht në formë elektronike në Zyrën e Koordinimit në Tiranë dhe te koordinatori për Shqipërinë.

Raportet dhe faturat duhet të dorëzohen në formë elektronike. Të gjitha raportet duhet të jenë me shkrim në gjuhën angleze. Faturat duhet të shpjegohen në gjuhën angleze ose gjermane.

Për më shumë në lidhje me përmbajtjen e raporteve dhe faturave, shih pikën 4 të kushteve të përgjithshme të kontratës.

§ 3 Pagesat dhe rimbursimi i kostove

1. Për kryerjen e detyrave të përshkruara në specifikimet e punës, shtojca 1, Kontraktuesi do të marrë:

1.1 Një shumë ose pagesa të tjera prej euro 330 839,77 (me fjalë: treqind e tridhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e shtatë euro) në përputhje me preventivin e kostove;

1.2 Rimbursimi i kostove direkte të projektit dhe shpenzimet e udhëtimit për një vlerë prej 454 160,23 euro (me fjalë: katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë presje njëzet e tre euro). Nëse do të jetë ligjërish e mundshme, shërbimet sipas kontratës do të kryhen në mënyrë që asnjë taksë austriake të mos vonohet për t'u paguar. Çdo taksë në vendin partner është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues.

2. Nëse zërat e kostove individuale në përmbajtje të preventivit të kostove (kostot direkte të projektit) tejkalojnë parashikimin deri në 10%, por jo më shumë se 5 000 euro dhe kjo vlerë mbulohet nga kursimet e bëra për zëra të tjerë, kjo nuk do të konsiderohet si tejkalim i kostove, vetëm në rast se kontrata e parashikon ndryshe.

3. Çdo modifikim i detyrave të specifikuara ose shërbimet shtesë që duhen siguruar, mbulohet nga pika 10 e kushteve të përgjithshme të kontratës.

§ 4 Kushtet e pagesës

1. Pagesat dhe rimbursimi i shpenzimeve të bëra do të bëhen nga llogaria e Kontraktuesit me Schelhammer & Schattera, të cilat do të përmbajnë detajet e mëposhtme: _____ nr. i llogarisë 00100 237908, BLZ. 19190, emri i llogarisë: "Horizont 3000, Gender Equita Albania", në afatet e përcaktuara më poshtë:

1.1 Pagesa e kështit të parë me vlerë prej euro 350 000,-- do të bëhet afërsisht 4 javë pas hyrjes në fuqi të kontratës – supozohet në dhjetor 2006,

1.2 Pagesa e kështit tjetër prej euro 80 000,-- do të bëhet brenda 6 javësh pas paraqitjes së raportit fillestar, prezantimit dhe shqyrtimit të deklaratës financiare të ndërmjetme në përputhje me seksionin 2(2) – supozohet në shkurt 2008;

1.3 Pagesa e kështit tjetër prej euro 150 000,-- do të bëhet brenda 6 javësh pas paraqitjes së raportit të ndërmjetëm, prezantimit dhe shqyrtimit të deklaratës financiare të ndërmjetme në përputhje me seksionin 2(2) – mendohet në shkurt 2009;

1.4 Pagesa e kështit tjetër prej euro 135 000,-- do të bëhet brenda 6 javësh pas paraqitjes së raportit të ndërmjetëm, prezantimit dhe shqyrtimit të deklaratës financiare të ndërmjetme në përputhje me seksionin 2(2) – mendohet në shkurt 2010;

1.5 Pagesa e vlerës përfundimtare prej euro 70 000,-- do të bëhet brenda 6 javësh pas paraqitjes së raportit përfundimtar, prezantimit dhe shqyrtimit të deklaratës financiare të ndërmjetme, në përputhje me seksionin 2(2) – supozohet në shkurt 2011.

2. Pagesat e pjesshme të bëra mbështetur në raporte afatshkurtra financiare nuk do të konsiderohen si pretendime për pagesa.

3. Në rastin kur Autoriteti Kontraktues ka bërë parapagime, Kontraktuesi do të investojë paratë me interes të paktën të barabartë me vlerën e depozitave të kursimit të pagueshme sipas kërkesës dhe do t'ia transferojë interesin e fituar Autoritetit Kontraktues, së bashku me deklaratën financiare të radhës ose nëse nuk ka më raporte afatshkurtra, së bashku me deklaratën financiare përfundimtare.

4. Pranimi i pagesës përfundimtare pas dorëzimit të faturës së fundit heq çdo mundësi për të kërkuar pagesa të tjera, me përjashtim të rastit kur fatura parashikon një rast të tillë ose kur ky pretendim është shprehur dhe justifikuar me shkrim brenda një muaji nga marrja e pagesës.

§ 5 Kushte të tjera kontraktuale

1. Në rast se për këtë projekt do të ofrohen nga palë të treta fonde shtesë të paparashikuara në këtë projekt (shih pikën § 1.1 të kontratës së shërbimit), financimi i ADA-s do të reduktohet sipas shumës së ofruar nga pala e tretë. Përfituesi është i detyruar të informojë menjëherë me shkrim ADA-n në rast se ka ndonjë financim shtesë. Këstet nga ADA do të reduktohen sipas planit të ri të pagesave, të miratuara nga të gjitha palët kontraktuese, i cili do të zëvendësojë detyrimet e

parashikuara në pikat § 3 dhe 4 të kontratës së shërbimit.

§ 6 Përdorimi i të dhënave nga Autoriteti Kontraktues dhe Donatori

Kontraktuesi vëren se të dhënat vetjake të vëna në dispozicion të tij me qëllim fillimin dhe përpunimin e kontratës, mund të përdoren nga Autoriteti Kontraktues, kur përdorimi i tyre përbën një parakusht të rëndësishëm për kryerjen e detyrimeve të ligjshme të Autoritetit Kontraktues ose kur kjo lejohet sipas seksioneve 7 dhe 9 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave 2000 (Datenschutzgesetz 2000), botuar në Fletoren Federale Juridike, nr.165/1999 të amenduar, në shërbim të zbatimit të kontratës, sikurse dhe për qëllime kontrolli. Gjatë përdorimit të këtyre të dhënave, mund të ndodhë që të jetë e nevojshme përcjellja e informacionit veçanërisht agjentëve ose përfaqësuesve të Gjykatës së Auditit, veçanërisht sipas kushteve të seksionit 3, paragrafi 2, seksionit 4, paragrafi 1 dhe seksionit 13, paragrafi 3 të ligjit mbi Gjykatën e Auditit (Rechnungshofgesetz), botuar në Fletoren Federale Juridike, nr. 144/1948, të amenduar, dhe në zbatim të dispozitave ligjore të BE-së.

§ 7 Juridiksioni dhe ligjet e zbatueshme

Për çdo mosmarrëveshje që mund të dalë nga kjo kontratë është rënë dakord që gjykata e distriktit të parë të Vjenës të ketë juridiksionin dhe autoritetin për ta zgjidhur atë.

Për çdo vendim, në lidhje me marrëdhëniet kontraktuale, do të zbatohet vetëm ligji austriak, me përjashtim të të gjitha referencave të mëtejshme ndaj ligjit të huaj.

§ 8 Dispozitat përfundimtare

1. Pretendimet që dalin nga kjo kontratë bëhen të vlefshme vetëm pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së grantit, mbi të cilën mbështetet kjo kontratë shërbimi.

2. Çdo modifikim ose përmirësim i kësaj kontrate duhet të bëhet me shkrim; kjo zbatohet gjithashtu për çdo devijim nga forma me shkrim.

3. Specifikimi i punës, shtojca 1, kushtet e përgjithshme të kontratës në versionin e vlefshëm në kohën e përfundimit të kontratës, shtojca 2 dhe deklarata e Kontraktuesit ndaj Donatorit, shtojca 3, formojnë pjesë përbërëse të kësaj kontrate. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, Kontraktuesi do të ketë përparësi, pasuar nga deklarata (shtojca 3), më pas nga specifikimet e punës dhe më tej nga kushtet e përgjithshme të kontratës.

4. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Kontraktuesi konfirmon, gjithashtu se ai ka marrë të gjitha shtojcat, të cilave u jemi referuar në këtë dokument dhe se është në dijeni të përmbajtjes së tyre.

Vula:

Autoriteti Kontraktues:

.....

Koço Barka,

Ministër

Tiranë, më 2006

Vula:

Kontraktuesi:

.....

Mag. Gerda Daniel

Drejtore Ekzekutive

Vjenë, më 2006

SHTOJCA 3 DEKLARATË

HORIZONT3000 - Organisation für Entwicklungszusammenarbeit, Wohllebengasse 12-14, 1040 Wien (ZVR-nr.657802754, i referuar këtu e tutje si pala nënshkruese e deklaratës) vëren se detyrimet për pagesat që burojnë nga kontrata e shërbimit për projektin me titull: "Programi i barazisë gjinore, Shqipëri" (referuar këtu e tutje si kontrata e shërbimit), kontratë e lidhur midis palës nënshkruese të Deklaratës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Rr. Kavaja 53, Tiranë, Shqipëri (referuar këtu e tutje si Përfituesi) dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, me adresë 1010 Vienna, Zelinkagasse 2 (referuar këtu e tutje si Donatori) merren përsipër nga Donatori për llogari të Përfituesit.

II.

Pala nënshkruese e deklaratës vëren se pas nënshkrimit të Marrëveshjes së grantit, Përfituesi autorizon Donatorin që të shqyrtojë kontabilitetin e projektit dhe merr përsipër që t'i dorëzojë

Donatorit raportet financiare sipas përshkrimit të bërë në seksionin 2 të kontratës së shërbimit dhe pikës 4 të kushteve të përgjithshme të kontratës.

III.

Pala nënshkruese e deklaratës është përgjegjëse kundrejt Donatorit për:

1. dorëzimin të Donatorit të raporteve financiare që mbulojnë të gjitha detyrat e kryera sipas kontratës, në përputhje me pikën 4 të kushteve të përgjithshme të kontratës dhe për të pranuar pagesat e bëra nga dhuruesi në vend të Përfituesit;

2. të mos hyjë në asnjë marrëveshje jozyrtare jashtë kontratës pa marrë më parë miratimin e Donatorit dhe t'i shkruajë Donatorit në kohë dhe përpara zbatimit, duke i kërkuar këtij të fundit të miratojë ndryshime sasiore apo cilësore ose të çmimeve të specifikuara në kontratë dhe për raste të rishikimit të shërbimeve (pika 1.6 e kushteve të përgjithshme të kontratës);

3. për njoftimin e menjëhershëm të Donatorit për çdo pagesë të bërë nga Përfituesi ose nga palë të tjera për shërbime të kryera sipas kontratës. Pala nënshkruese e kontratës vëren që pagesat e bëra nga dhuruesi për shërbimet e kryera sipas kontratës do të reduktohen në një vlerë të barabartë me vlerën e pagesave të lartpërmendura në rastet kur shërbimet e kryera janë shërbime shtesë të paparashikuara në kontratën e shërbimit;

4. dorëzimin të Donatorit të raporteve mbi detyrat e kryera sipas kontratës, sipas parashikimeve në seksionin 2 të kontratës së shërbimit dhe pikës 4 të kushteve të përgjithshme të kontratës, së bashku me dokumentet e nevojshme për vlerësimin;

5. për njoftimin e menjëhershëm të Donatorit për çdo lloj rrethane që do të mund ta vononte ose ta bënte të pamundur kryerjen e detyrës ose zbatimin e projektit për të cilin premtohet granti ose nevojën për të përmirësuar kontratën e shërbimit dhe për të dorëzuar sugjerimet e nevojshme mbi masat që duhen marrë. Nëse njoftimi nuk bëhet me shkrim, ai duhet të konfirmohet me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur;

6. për të ndrequr çdo defekt, me kërkesë të Donatorit, pas përfundimit të detyrës, pa prituri që të marrë pagesa të tjera dhe brenda një periudhë kohe të pranueshme dhe të përmbushë detyrimet e tij për garancitë sipas kontratës së shërbimit, në përputhje me pikën 12 të kushteve të përgjithshme të kontratës;

7. për t'i kthyer Donatorit, me kërkesë të këtij të fundit, paratë në vlerën e paguar nëse dhuruesi ka të drejtë për t'u ripaguar nga pala nënshkruese e kësaj deklarate sipas kushteve të kontratës së shërbimit;

8. për të mos premtuar, transferuar apo dhënë të drejta që burojnë nga kjo kontratë. Çdo e drejtë e transferuar në këtë mënyrë nuk do të ishte e zbatueshme në lidhje me Donatorin;

9. për të përfutur nga shërbimet që ofron Përfituesi dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet ndaj Donatorit, të cilat parashikohen në pikën 1.9 të kushteve të përgjithshme të kontratës.

IV.

Pala nënshkruese e kësaj deklarate vëren se:

1. pas përfundimit të deklaratës së grantit, çdo pretendim i ngritur nga Përfituesi që buron nga kontrata e shërbimit ndaj palës nënshkruese të deklaratës, do t'i kalojë Donatorit me kërkesë të Përfituesit;

2. Përfituesi i njeh Donatorit të drejtën e pronësisë mbi shërbimet intelektuale që burojnë nga kontrata e shërbimit, me palën nënshkruese të deklaratës (pika 14.3 e kushteve të përgjithshme të kontratës). Këto të drejta nuk kufizohen në kohë dhe as në hapësirë dhe mund t'u jepen palëve të treta;

3. Përfituesi pranon të garantojë që për kryerjen e detyrave në përputhje me kushtet e kontratës, monitorimin e projektit të bërë nga Donatori (do të bëhet shqyrtimi i detyrave të parashikuara në kontratë nga ekspertët). Ai merr përsipër të ndihmojë në monitorimin e projektit në çdo mënyrë të mundshme;

4. Donatori ka të drejtë të hartojë ose autorizojë hartimin e raportit përfundimtar financiar, nëse ky raport nuk dorëzohet në kohë. Kostot që do të shkaktohen nga kjo do të paguheshin nga pala nënshkruese e deklaratës (pika 4.5 e kushteve të përgjithshme të kontratës).

V.

Pala nënshkruese e deklaratës i jep Donatorit të drejtat e mëposhtme për kontroll

1. Pala nënshkruese e deklaratës merr përsipër të lejojë agjentë dhe përfaqësues të Donatorit që në çdo kohë të shqyrtojnë plotësisht regjistrat dhe faturat dhe çdo dokumentacion tjetër që tregon zbatimin e duhur të projektit, si dhe të kryejnë inspektime në terren.

Më tej, ajo merr përsipër të japë informacionin e nevojshëm në lidhje me projektin dhe sipas kërkesës, të japë raporte shtesë mbi detyrat dhe kontabilitetin. Pala inspektuese përcakton nëse informacioni i kërkuar lidhet me projektin.

2. Pala nënshkruese e kësaj deklarate bie dakord për shqyrtimin e detyrës dhe të kontabilitetit të projektit nga Gjykata e Auditit sipas seksionit 13, paragrafi 3 i ligjit mbi Gjykatën e Auditit, 1948, botuar në Fletoren Juridike Federale nr.144, të amenduar (pika 5.1 e kushteve të përgjithshme të kontratës);

3. Pala nënshkruese e deklaratës deklaron vullnetin e saj për të lejuar Donatorin që të marrë informacionin që lidhet me projektin nga palë të treta, veçanërisht nga autoritetet tatimore, bankat dhe autorizon këto palë të treta që ta japin këtë informacion. Kjo nuk vlen për institucionet publike.

VI.

Kontabiliteti do të mbulojë të gjithë menaxhimin financiar të detyrës. Blloqet dhe faturat do të ruhen për të paktën dhjetë nga deklarimi i Donatorit se të gjitha detyrimet që burojnë nga kontrata janë përmbushur nga Pala nënshkruese e deklaratës. Donatori mund të kërkojë në çdo kohë që këto dokumente të ruhen për periudhë kohore edhe më të gjatë.

VII.

Nëse kjo deklaratë nënshkruhet nga më shumë se një person, atëherë ata do të jenë bashkërisht përgjegjës për të.

Kontraktuesi:

.....

Mag. Gerda Daniel

Drejtoreshë Ekzekutive

Vjenë, më..... 2006

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500
 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600
 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300
 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500

Botime të reja

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500

Hyri në shtyp më 10.7.2007
 Doli nga shtypi më 11.7.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë